



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE PROCEDURALE LIGJORE DHE MARRËDHENIEVE ME JASHTË

Nr. 656 Prot.

Tiranë, më 13 / 11 / 2013

Lënda: Rekomandim për marrjen e masave për regjistrimin e fëmijëve të komunitetit Rom në regjistrat e gjendjes civile në njësitë vendore ku ata kanë vendbanimin aktual.

Drejtuar: Zyrës së Gjendjes Civile, Lezhë

LEZHË

Për dijeni: Z. Saimir TAHIRI
Ministër
Ministria e Punëve të Brendshëm

TIRANË

Në kuadër të projektit me titull *“Për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të personave të diskriminuar”*, të Komitetit Shqiptar të Helsinkit (KShH) në partneritet me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbështetur financiarisht nga Zyra e Kooperacionit Zviceran në Tiranë, po zhvillohen Ditë të Hapura, që synojnë rritjen e ndërgjegjësimit për Ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi” si dhe njohjen me problematikat që shqetësojnë komunitetin.

Në takimin e zhvilluar me komunitetin në Bashkinë e Lezhës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe KShH kanë evidentuar disa problematika, ndër të cilat mosregjistrimi i fëmijëve të lindur nga prindër jo të celebruar ligjërisht pranë gjendjes civile, për shkak të moshës së mitur të gruas. Sipas informacionit të dhënë nga disa përfaqësues të komunitetit, i është këshilluar nga gjendja civile ti drejtohen rrugës gjyqësore.



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

Kemi konstatuar se mungesa e informacionit, si dhe mungesa e burimeve financiare për të ndjekur procedurat ligjore, ka bërë që në shume raste këta shtetas të mos figurojnë të regjistruar në gjendjen civile pranë familjeve të tyre.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në përmbushje të qëllimit të ligjit nr. 10 221 datë 04.02.2010 "*Për mbrojtjen nga diskriminimi*" për të garantuar të drejtën e çdo personi për barazi përpara ligjit, mbrojtje të barabartë nga ligji dhe mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjellje që nxit diskriminimin dhe bazuar në kompetencën që i jepet në bazë të **shkronjës "F", të pikës 1, të nenit 32, të këtij ligji, për të bërë rekomandime për çfarëdo lloj çështje që lidhet me diskriminimin konstaton:**

Legjislacioni ynë e ka të parashikuar qartazi mënyrën e regjistrimit të fëmijëve. Ligji nr. 10 129, datë 11.5.2009 "*Për Gjendjen Civile*", **nenit 40, pika 1**, parashtron: "*Lindja e fëmijës deklarohet te nëpunësi i gjendjes civile nga prindërit, pjesëtarët madhorë të familjes, përfaqësuesit ligjorë ose kujdestarët, dhe, në pamundësi ose në mungesë të tyre, nga personat, që kanë të drejtë të vërtetojnë lindjen. Deklarimi mund të bëhet edhe nga përfaqësues të nënës, me prokuror të posaçme*". Ndërkohë **neni 41, pika 1** parashtron: "*Regjistrimi i lindjes së fëmijës bëhet në zyrën e gjendjes civile të vendbanimit të prindërve ose në vendin ku ka ndodhur lindja*".

Bazuar në Udhëzimin e Ministrit të Punëve të Brendshme, nr.7, datë 10.01.2012, pika 1/a, detyrohen përfaqësuesit e njësisë vendore të përcaktuar më parë nga titullari përkatës që: "*Kur konstatohen, fëmijë, të cilët janë të pajisur me "certifikatën e asistencës në lindje"/"proces-verbalin e hartuar në kohën e lindjes", por që për shkaqe të ndryshme nuk janë të regjistruar dhe nënat e tyre i kanë lënë nën kujdesin e të afërmeve, të merren masa për regjistrimin e tyre*".

Pra pengesa ligjore për regjistrimin e fëmijëve të lindur nga nëna të pamartuara ligjërisht nuk ka. Sipas parashikimeve ligjore dhe nënligjore në çdo rast rregjistrimi i fëmijëve mund të realizohet drejtëpërdrejt në rrugë administrative. Rruga gjyqësore shoqërohet me procedura më të zgjatura dhe me kosto financiare. Komuniteti rom për vetë kushtet që ka, e ka të vështirë për të ndjekur rrugën gjyqësore.



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

Gjithashtu, Kodi i Procedurave Administrative në Nenin 13, pika 1/a parashtroi: “*Organet e administratës publike u sigurojnë personave privatë informacionin dhe sqarimet e nevojshme*”.

Mosdhënia e informacionit për komunitetin rom dhe mosinformimi për lehtësirat që parashikon ligji, duke i dërguar ato drejtë rrugës më të kushtueshme, si ajo gjygjësore sjell drejtëpërdrejt diskriminimin e tyre.

Në mbështetje të nenit 15, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i cili i cilëson të drejtat dhe liritë themelore të njeriut si “të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe që qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik”, duke sanksionuar kështu barazinë pa asnjë lloj diskriminimi të të gjithë shtetasve që jetojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të Planit Kombëtar të Veprimit 2010-2015, lidhur me identifikimin dhe regjistrimin e pjesëtarëve të komunitetit Rom të paregjistruar, me qëllim mbrojtjen e të drejtave dhe aksesin në shërbime, **Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi:**

REKOMANDON:

Marrjen e masave për regjistrimin e fëmijëve të komunitetit Rom në regjistrat e gjendjes civile përmes zbatimit me korrektësi të ligjit të gjendjes civile dhe aktet nënligjore të tij.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

Konc: Amarda Coku, Specialiste



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al